



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.73

2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.4954 datë 4.7.2006	Për emërim ambasadori	2107
Dekret nr.4955 datë 4.7.2006	Për emërim ambasadori.....	2107
Vendim i KM nr.410, datë 21.6.2006	Për kërkesat teknike dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit të instrumenteve të peshimit joautomatik.....	2108
Udhëzim i MPÇSSHB nr.1468, datë 26.6.2006	Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.223, datë 19.4.2006 "Për pagesën e të ardhurës nga papunësia"....	2122
Vendim i KKRT nr.464, datë 29.06.2006	Për televizionin vendor privat "BLUE SKY".....	2125
Vendim i KKRT nr.465, datë 29.06.2006	Për mosdhënie licence për televizionin vendor privat "GOLD".....	2125
Vendim i KKRT nr.466, datë 29.06.2006	Për dhënie licence për radio vendore private "LOGOS".....	2126
Vendim i KKRT nr.467, datë 29.06.2006	Për dhënie licence për televizionin vendor privat "FOKUS"...	2127
Vendim i KKRT nr.468, datë 29.06.2006	Për mosdhënie licence për televizionin kabllor privat "TV HIMARA".....	2127
Vendim i KKRT nr.469, datë 29.06.2006	Për mosdhënie licence për televizionin kabllor privat "ERZENI".....	2128

Vendim i KKRT nr. 470, datë 29.06.2006	Për dhënie licence për televizionin vendor privat “ALB- WEST”.....	2129
Vendim i KKRT nr.471, datë 29.06.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik me përsëritës “RADIO ITALIA”	2129
Vendim i KKRT nr.472, datë 29.06.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV MIRDITA”.....	2130
Vendim i KKRT nr.473, datë 29.06.2006	Për zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit televiziv kabllor privat “KUKËSI”	2130
Vendim i KKRT nr.480, datë 29.06.2006	Mbi pavlefshmërinë e licencës së tv vendor “ANTENA JUG”.....	2131
Vendim i KKRT nr.482, datë 29.06.2006	Mbi reduktimin e kohës së vlefshmërisë së licencës së TV “ABC”	2132
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Ilirjan Kacaj.....	2134

DEKRET
Nr.4954, datë 4.7.2006

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika dh, dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Admirim Banaj, Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë, rezident në Mbretërinë e Arabisë Saudite, Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë, jorezident në Mbretërinë e Bahrenit, në Kuvait, në Sulltanatin e Omanit, në Katar dhe në Emiratet e Bashkuara Arabe, të emërohet Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Jemenit, jorezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.4955, datë 4.7.2006

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika dh, dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Aleksandër Sallabanda, Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Uashington, të emërohet Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara të Meksikës, Republikën e Panamasë dhe në Republikën Domenikane.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.410, datë 21.6.2006

PËR KËRKESAT TEKNIKE DHE PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT TË INSTRUMENTEVE TË PESHIMIT JOAUTOMATIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 10 të ligjit nr.9097, datë 3.7.2003 “Për vlerësimin e konformitetit”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Procedurat e vlerësimit të konformitetit dhe kërkesat teknike të instrumenteve të peshimit joautomatik janë sipas përcaktimeve të mëposhtme:

1. Vlerësimi i konformitetit për instrumentet e peshimit joautomatik bëhet nga organizma të autorizuar, në bazë të kërkesave teknike, sipas anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Organizmi i autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit të peshoreve, i përcaktuar me vendimin nr.723, datë 5.11.2004 të Këshillit të Ministrave dhe strukturat publike të kontrollit të tregut, të përcaktuara në ligjin nr.9135, datë 11.9.2003 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” marrin të gjitha masat, që të mos lejojnë hedhjen në treg dhe vënien në përdorim të peshoreve, të cilat nuk plotësojnë kërkesat e këtij vendimi.

3. Strukturat publike të kontrollit të tregut, kur gjykojnë se peshoret, të cilat mbajnë markën CE të konformitetit, nuk plotësojnë gjatë përdorimit kërkesat e këtij vendimi, megjithëse janë instaluar dhe përdoren për qëllimet e caktuara nga prodhuesi, i bllokojnë ato, nuk lejojnë hedhjen në treg të peshoreve të tjera të këtij tipi dhe njoftojnë strukturat përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve, duke treguar edhe arsyet.

4. Instrument peshimi joautomatik është një mjet, që kërkon ndërhyrjen e operatorit gjatë procesit të peshimit, e që më poshtë do të emërohet “peshore”. Funksioni i peshoreve është përcaktimi i masës së një trupi, duke shfrytëzuar forcën e rëndesës dhe të madhësive të tjera, që lidhen me të. Ato përdoren për përcaktimin e masës në:

- transaksionet tregtare;
- zbatimin e akteve ligjore, për opinionet e ekspertit, të dhëna në gjyq;
- përgatitjen e ilaçeve gjatë trajtimit mjekësor, diagnostikimit dhe monitorimit të të sëmurit;
- medikamentet, që përgatiten në farmaci dhe në analizat, që kryhen në laboratorët mjekësorë dhe farmaceutikë;

- shitjen ndaj popullatës dhe përgatitjen e produkteve të paketuara.

5. Peshoret, të cilat përdoren, sipas përcaktimeve të pikës 4 të këtij vendimi, duhet të plotësojnë kërkesat kryesore, të dhëna në aneksin nr.1 të këtij vendimi. Në rastet kur peshorja ka apo është e lidhur me pajisje, të cilat nuk përdoren sipas përcaktimeve të bëra në pikën 4 të këtij vendimi, pajisje të tilla nuk janë subjekt i zbatimit të kërkesave kryesore.

Peshoret e përdorura jashtë përcaktimeve të bëra në pikën 4 të këtij vendimi nuk vlerësohen si instrumente ligjore dhe nuk janë subjekt i vlerësimit të konformitetit.

6. Vendosja e gabuar e markës CE të konformitetit është përgjegjësi e prodhuesit apo importuesit dhe vlerësohet se është vendosur gabim në rastet e mëposhtme kur:

- prodhuesi ka vendosur të prodhojë peshoren sipas standardeve përkatëse, por ato nuk e plotësojnë këtë kërkesë;
- peshoret nuk janë në përputhje me tipin e miratuar;
- peshoret e prodhuara janë në përputhje me tipin e miratuar, por ai nuk plotëson kërkesat kryesore, që zbatohen për të;
- prodhuesi nuk ka plotësuar detyrimet (garancinë e cilësisë së prodhimit), që i lejojnë atij deklarimin CE të konformitetit të tipit.

7. Prodhuesi apo importuesi, para hedhjes në treg të peshoreve, që përdoren sipas përcaktimeve të pikës 4 të këtij vendimi, siguron vlerësimin e konformitetit të tyre me kërkesat kryesore, të paraqitura në aneksin nr.1, duke aplikuar njërën nga procedurat e mëposhtme:

a) Ekzaminimin CE të tipit, përcaktuar në pikën 1 të aneksit nr.2, i ndjekur nga:

- deklarimi CE i konformitetit të tipit (garancia e cilësisë së peshores), përcaktuar në pikën 2 të

aneksit nr.2;

- verifikimi CE i konformitetit me tipin, përcaktuar në pikën 3, të aneksit nr.2.

Ekzaminimi CE i tipit nuk është i detyrueshëm për peshoret, të cilat nuk përdorin pajisje elektronike dhe sistemi matës nuk përdor sustë për të balancuar ngarkesën.

- b) verifikimin CE të njësisë (prodhim unik), paraqitur në pikën 4 të aneksit nr.2.

7.1. Prodhuksi apo importuesi vendos në peshoret, të cilat plotësojnë kërkesat e këtij vendimi, vendos markën shqiptare të konformitetit, si përcaktohet në aneksin nr.2, dhe shenjat plotësuese të markimit, si përcaktohet në aneksin nr.4.

7.2. Deklarimi i konformitetit paraqitet në gjuhën shqipe ose në anglisht, dhe përmban dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) të dhënat identifikuese të prodhuesit ose të importuesit, që lëshon deklaratën e konformitetit;

- b) të dhënat identifikuese për peshoren;

- c) përshkrimin dhe funksionin e peshores;

- ç) listën e rregullave teknike dhe të standardeve të harmonizuara, të aplikuara, kur është vlerësuar konformiteti;

- d) të dhënat e procedurës së përdorur për vlerësimin e konformitetit;

- dh) të dhënat e organizimit të autorizuar;

- e) konfirmimin e prodhuesit apo të importuesit, për përputhjen e peshores me kërkesat teknike;

- ë) vendin dhe datën e lëshimit të deklaratës së konformitetit, emrin dhe pozicionin e personit të ngarkuar nga prodhuesi apo importuesi dhe nënshkrimin e tij.

8. Prodhuksi, para hedhjes në treg të peshores, siguron vlerësimin e konformitetit me kërkesat kryesore, të paraqitura në aneksin nr.1, duke aplikuar njërën nga procedurat e mëposhtme:

- a) Ekzaminimin CE të tipit, përcaktuar në pikën 1 të aneksit nr.2, të ndjekur nga:

- deklarimi CE i konformitetit të tipit (garancia e cilësisë së peshores), përcaktuar në pikën 2 të aneksit nr.2;

- verifikimi CE i konformitetit me tipin, përcaktuar në pikën 3 të aneksit nr.2.

- b) Verifikimin CE të njësisë, (prodhim unik), përcaktuar në pikën 4 të aneksit nr.2.

Ekzaminimi CE i tipit nuk është i detyrueshëm për peshoret, të cilat nuk përdorin pajisje elektronike dhe sistemi matës nuk përdor sustë për të balancuar ngarkesën.

8.1. Prodhuksi vendos në peshoret, të cilat plotësojnë kërkesat e këtij vendimi, markën CE të konformitetit dhe mbishkrime të tjera, të nevojshme. Mbishkrimet e markimit, që shënohen në peshore, të përcaktuara në pikën 1 të aneksit nr.4, duhet të jenë të qarta, të lexueshme dhe që nuk fshihen. Ndalohet vendosja në këto peshore e mbishkrimeve, të cilat krijojnë konfuzion me markën CE të konformitetit.

8.2. Peshoret e përdorura, sipas përcaktimeve të pikës 4 të këtij vendimi, të cilat kanë të përfshira apo janë të lidhura me pajisje, që nuk janë subjekt i vlerësimit të konformitetit, kanë, secila prej tyre, shënimin e përdorimit të kufizuar, siç tregohet në pikën 3 të aneksit nr.4.

8.3 Vendorsja e markës CE të konformitetit në peshore nënkupton përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në aktet e tjera ligjore.

9. Veprimtaritë e prodhuesve të peshoreve, të përcaktuara në pikat 8 dhe 8.2 të këtij vendimi, realizohen nga organizmat e autorizuar, të njohura nga Komuniteti Europian. Këto organizma duhet të plotësojnë kriteret minimale, të dhëna në aneksin nr.5 të këtij vendimi.

10. Peshoret, për të cilat nuk është vendosur dhëna e markës CE, duhet të kenë të shënuar mbishkrimet, e caktuara në pikën 2 të aneksit 4, në vende të dukshme, të cilat lexohen me lehtësi dhe që nuk fshihen. Ndalohet vendosja në këto peshore e shenjave, të cilat mund të ngatërrohen me markën CE të konformitetit.

11. Certifikatat e vlerësimit të konformitetit dhe dokumentet e tjera respektive, të miratuara sipas legjislacionit përkatës, që ka qenë në fuqi, janë efektive për të gjithë periudhën, për të cilën ato janë miratuar.

12. Të gjitha subjektet duhet të heqin nga përdorimi, brenda datës 31 dhjetor 2010, peshoret e përdorura, sipas përcaktimeve të pikës 4, nëse ato nuk plotësojnë kërkesat e këtij vendimi.

13. Pika 9 e këtij vendimi, ditën e anëtarësimit të vendit tonë në Bashkimin Europian, shfuqizohet.

Pika 10 këtij vendimi hyn në fuqi ditën e anëtarësimit të vendit tonë në Bashkimin Europian.

14. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI NR.1

KËRKESA KRYESORE

HYRJE

Kur një peshore, e cila përdoret sipas përcaktimeve të pikës nr.3 të këtij vendimi, përfshin ose është lidhur me më shumë se një pajisje tregimi ose printimi, të cilat përsërisin rezultatet e veprimit të peshimit dhe që nuk influencojnë në funksionimin korrekt të peshores, nuk janë subjekt i kërkesave kryesore në qoftë se rezultatet e peshimit janë printuar ose ruajtur saktësisht dhe të paheqshme nga një pjesë e peshores, e cila plotëson kërkesat kryesore dhe rezultatet janë të pranueshme për të dy palët që janë të interesuara për matjen. Megjithatë, në rastin e peshoreve të përdorura për shitje direkte në publik, pajisja e tregimit dhe e printimit për klientin dhe shitësin duhet të plotësojë kërkesat kryesore.

KËRKESA METROLOGJIKE

1. Njësitë e matjes

Njësitë e përdorura duhet të jenë njësitë e shpallura në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.431, datë 26.6.2003 “Për njësitë ligjore të matjes”.

Njësitë SI: kilogram, microgram, miligram, gram, ton

2. Klasat e saktësisë

2.1 Klasat e saktësisë janë përcaktuar si më poshtë:

I Speciale

II E lartë

III Mesatare

IIII E zakonshme

Specifikimet për këto klasa janë dhënë në tabelën 1.

Tabela nr.1

Klasat e saktësisë

Klasa e saktësisë	Ndarja verifikuese e shkallës e	Kapaciteti minimal Min (Kufiri i poshtëm)	Numri i ndarjeve verifikuese të shkallës $n = \text{Max} / e$	
			minimal	maximal

Speciale				
I	$0.001 \text{ g} \leq e$	100 e	50 000	-
E lartë	$0.001 \text{ g} \leq e \leq 0.05 \text{ g}$	20 e	100	100 000
II	$0.1 \text{ g} \leq e$	50 e	5 000	100 000
E mesme	$0.1 \text{ g} \leq e \leq 2 \text{ g}$	20 e	100	10 000
III	$5 \text{ g} \leq e$	20 e	500	10 000
E zakonshme	$5 \text{ g} \leq e$	10 e	100	1 000
III				

Kapaciteti minimal është zvogëluar në 5e për instrumente të klasës II dhe III për përcaktimin e tarifës së transportit.

2.2 Ndarjet e shkallës

2.2.1 Ndarja reale e shkallës (d) dhe ndarja verifikuese e shkallës (e) duhet të jetë në formën:

1×10^k , 2×10^k , ose 5×10^k njësi të masës, ku k është një numër i plotë ose zero.

2.2.2 Për të gjithë peshoret ndryshe nga ato me pajisje treguese ndihmëse:

$$d = e$$

2.2.3 Për peshoret me pajisje treguese ndihmëse zbatohen kushtet e mëposhtme:

$$e = 1 \times 10^k \text{ g}$$

$$d < e \quad 10 d$$

përveç peshoreve të klasës I me $d < 10^{-4} \text{ g}$, për të cilat $e = 10^{-3} \text{ g}$.

3. Klasifikimi

3.1 Peshore me një diapazon peshimi

Peshore e pajisura me një pajisje treguese ndihmëse do t'i përkasin klasës I ose klasës II. Për këto dy klasa peshorësh, kufijtë e poshtëm të kapacitetit minimal merren nga tabela 1, duke zëvendësuar te kolona e tretë ndarjen verifikuese të shkallës (e) me ndarjen reale të shkallës (d).

Në qoftë se $d < 10^{-4} \text{ g}$, kapaciteti maksimal i klasës I mund të jetë më i vogël se sa 50000 e.

3.2 Peshore me shumë kufij peshimi

Peshore me shumë kufij peshimi është e lejuar, me kusht që ato të tregohen qartë mbi peshore.

Çdo kufi peshimi individual klasifikohet sipas pikës 3.1 të këtij aneksi. Në qoftë se kufijtë e peshimit u takojnë klasave të ndryshme të saktësisë, peshorja duhet të veprojë në përputhje me kërkesat më të forta që zbatohen për klasat e saktësisë në të cilën bien kufijtë e peshimit.

3.3 Peshore me shumë intervale

3.3.1 Peshore me shumë intervale janë instrumente me një kufi peshimi i cili ndahet në kufij të pjesshëm peshimi, secili me vlerë ndarje shkalle të ndryshme, një nga ato jepet automatikisht sipas ngarkesës që zbatohet në rritje ose në zbritje.

Peshoret me shumë intervale peshimi nuk duhet të pajisen me pajisje treguese ndihmëse.

3.3.2 Çdo kufi i pjesshëm peshimi i peshoreve me shumë intervale përcaktohet nga:

- ndarja verifikuese e shkallës tij, e_i me $e_{(i+1)} > e_i$
- kapaciteti maksimal i tij, Max_i me $\text{Max}_r = \text{Max}$
- kapaciteti minimal i tij, Min_i me $\text{Min}_i = \text{Max}_{(i-1)}$ dhe $\text{Min}_1 = \text{Min}$

ku:

$$i = 1, 2, \dots, r$$

i = numri i kufirit të pjesshëm të peshimit

r = numri i përgjithshëm i kufijve të pjesshëm të peshimit

Të gjitha kapacitetet janë kapacitete të ngarkesës neto, pavarësisht nga vlera e përdorimit të ndonjë tare.

3.3.3 Kufijtë e pjesshëm të peshimit janë klasifikuar sipas tabelës nr.2. Të gjithë kufijtë e pjesshëm të peshimit, duhet të bien brenda së njëjtës klasë saktësie, kjo klasë do të jetë klasa e saktësisë së peshores.

Tabela nr.2

Peshore me shumë intervale

Klasa	Ndarja verifikuese e shkallës (e)	Kapaciteti minimal (Min) Vlera minimale	Numri i ndarjeve verifikuese të shkallës	
			Vlera minimale ¹⁾ $n = \text{Maxi}/e(i+1)$	Vlera maksimale $a = \text{Maxi}/ei$
I	$0.001 \text{ g} \leq ei$	100 ei	50 000	-
II	$0.001 \text{ g} \leq ei \leq 0.05 \text{ g}$	20 ei	5 000	100 000
	$0.1 \text{ g} \leq ei$	50 ei	5 000	100 000
III	$0.1 \text{ g} \leq ei \leq 2 \text{ g}$	20 ei	500	10 000
III	$5 \text{ g} \leq ei$	10 ei	100	1 000

¹⁾ Për $i=r$ zbatohet kolona korresponduese e tabelës nr.1, duke zëvendësuar e me e_r .

4. Saktësia

4.1 Me zbatimin e procedurave të dhëna në pikat 3 ose 4 gabimi i tregimit duhet të mos kalojë gabimin më të madh të lejuar siç tregohet në tabelën nr.3. Në rastin e tregimit shifror, gabimi në tregim duhet të korrigjohet për gabimin e rumbullakuar.

Gabimi më i madh i lejuar zbatohet në vlerën tarë dhe neto për të gjitha ngarkesat e mundshme, duke përjashtuar vlerat e paravendosura të tarës.

Tabela nr.3

Gabimet më të mëdha të lejuara

Ngarkesa				Gabimi më i madh i lejuar
Klasa I	Klasa II	Klasa III	Klasa IIII	
$0 \leq m \leq 50\ 000 \text{ e}$	$0 \leq m \leq 5\ 000 \text{ e}$	$0 \leq m \leq 500 \text{ e}$	$0 \leq m \leq 50 \text{ e}$	$\pm 0.5 \text{ e}$
$50\ 000 \text{ e} < m \leq 200\ 000 \text{ e}$	$5\ 000 \text{ e} < m \leq 20\ 000 \text{ e}$	$500 \text{ e} < m \leq 2\ 000 \text{ e}$	$50 \text{ e} < m \leq 200 \text{ e}$	$\pm 1 \text{ e}$
$200\ 000 \text{ e} < m$	$20\ 000 \text{ e} < m \leq 100\ 000 \text{ e}$	$2\ 000 \text{ e} < m \leq 10\ 000 \text{ e}$	$200 \text{ e} < m \leq 1\ 000 \text{ e}$	$\pm 1.5 \text{ e}$

4.2 Gabimet më të mëdha të lejuara në shërbim janë dy herë më të mëdha se ato të dhëna në seksionin 4.1.

5. Rezultatet e peshimit të një peshorejeje duhet të jenë të përsëritshme, dhe të riprodhueshme nga përdorimi i një tjetër pajisjeje treguese dhe me përdorimin e të tjera metodave balancimi.

Rezultatet e peshimit duhet të jenë mjaft të pandjeshme për të ndryshuar nga pozicioni i ngarkesës mbi marrësin e ngarkesës.

6. Peshorja duhet të reagojë ndaj ndryshimeve të vogla të ngarkesës.

7. Madhësitë influencuese dhe koha

7.1 Peshoret e klasës II, III dhe IIII të detyruara për të punuar në pozicion të pjerrët, duhet të jenë mjaft të pandjeshme ndaj vendosjes së pjerrët kundrejt asaj që ekziston në kushte normale të instalimit.

7.2 Peshoret duhet të plotësojnë kërkesat metrologjike brenda kufirit të temperaturës së dhënë nga prodhuesi. Vlera e këtij kufiri duhet të jetë të paktën me:

5 °C për peshoret e klasës së I

15 °C për peshoret e klasës së II

30 °C për peshoret e klasës së III ose IIII

Në mungesë të specifikimeve të prodhuesit, duhet të zbatohet kufiri i temperaturës prej -10 °C deri + 40 °C.

7.3 Peshoret që punojnë me ushqim nga rrjeti duhet të plotësojnë kërkesat metrologjike nën konditat e rrjetit elektrik brenda kufijve të luhatjeve normale.

Peshoret që punojnë me bateri duhet të tregojnë kurdoherë, kur tensioni zbret poshtë vlerës minimale të kërkuar dhe nën këto rrethana duhet të vazhdojnë të punojnë me saktësi ose automatikisht të dalin jashtë shërbimit.

7.4 Peshoret elektronike, përveç atyre të klasës I dhe të II kur e është më e vogël se sa 1 g, duhet të plotësojnë kërkesat metrologjike nën kondita të një lagështire relative të lartë dhe në kufirin e sipërm të diapazonit të temperaturës së tyre.

7.5 Ngarkimi i peshores së klasës II, III ose IIII për një periudhë kohe të zgjatur duhet të ketë një influencë të parëndësishme në tregimin e ngarkesës ose në tregimin e zeros, menjëherë sapo të kemi hequr ngarkesën.

7.6 Nën kondita të tjera peshoret duhet ose të funksionojnë në rregull ose të dalin automatikisht jashtë veprimit.

PROJEKTI DHE KONSTRUKSIONI

8. Kërkesa të përgjithshme

8.1 Projekti dhe konstruksioni i peshoreve duhet të jetë i tillë që ato të ruajnë cilësitë e tyre metrologjike kur instalohen dhe përdoren siç duhet, dhe kur përdoren në një ambient për të cilin ato janë parashikuar. Vlera e masës duhet të tregohet.

8.2 Kur ekspozohen ndaj ndërhyrjeve, tregimi i peshoreve elektronike nuk duhet të influencohen nga ato ose automatikisht duhet t'i diktojnë dhe t'i tregojnë ato.

Me zbulimin e gabimit të rëndësishëm, peshoret elektronike duhet të sigurojnë një alarm akustik ose të dukshëm i cili duhet të vazhdojë deri kur përdoruesi të ndërmarrë një veprim korrigjues ose gabimi të zhduket.

8.3 Kërkesat e pikës 8.1 dhe 8.2 duhet të plotësohen në baza të qëndrueshme gjatë një periudhe kohe që është normale nga pikëpamja e parashikimit të përdorimit të këtyre peshoreve.

Pajisjet elektronike shifrore gjithmonë duhet të ushtrojnë kontroll të mjaftueshëm të punës së saktë në procesin e matjes të pajisjes së tregimit, dhe të gjitha të dhënat të ruajtura dhe të dhënat që transferohen.

Mbas zbulimit automatik të gabimit të rëndësishëm e të qëndrueshëm, peshoret elektronike duhet të sigurojnë një alarm akustik ose të dukshëm i cili duhet të vazhdojë deri kur përdoruesi të

ndërmarrë një veprim korrigjues ose gabimi të zhduket.

8.4 Kur pajisja e jashtme është lidhur me një peshore elektronike ndërmjet një bashkimi të përshtatshëm, cilësitë metrologjike të peshores nuk duhet të keqësohen.

8.5 Peshoret nuk duhet të kenë karakteristika të tilla që lehtësojnë përdorimin mashtrues, ndërkohë që mundësitë për keqpërdorim të paqëllimshëm duhet të jenë minimale. Komponentët, të cilët nuk duhet të çmontohen ose të rregullohen nga përdoruesi, duhet të jenë të siguruara ndaj veprimeve të tilla.

8.6 Peshoret duhet të projektohen për të lejuar kryerjen lehtësisht të kontrolleve të ligjshme të paraqitura në këtë vendim.

9. Tregimi i rezultateve të peshimit dhe vlerave të tjera të peshës

Tregimi i rezultateve të peshimit dhe i vlerave të tjera të peshës duhet të jetë i saktë, i qartë dhe jo i keqinterpretueshëm dhe pajisja treguese në kondita normale përdorimi duhet të lejojë lexim të lehtë të tregimit.

Emrat dhe simbolet e njësive që i referohen paragrafit 1 të këtij aneksi duhet të jenë në përputhje me kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.431, datë 26.6.2003 “Për njësitë ligjore të matjes”, me shtimin e simbolit për karatin metrik i cili duhet të jetë “ct”.

Tregimi nuk duhet të jetë i mundur mbi kapacitetin maksimal (max), të rritur me 9e.

Pajisja ndihmëse e tregimit lejohet vetëm në të djathtë të presjes dhjetore. Pajisja e zgjerimit të tregimit mund të përdoret vetëm përkohësisht, ndërsa printimi duhet të jetë i papërdorshëm gjatë funksionimit të saj.

Mund të shfaqen tregime dytësore, me kusht që ato nuk duhet të ngatërrohen me tregimet fillestare.

10. Printimi i rezultateve të peshimit dhe vlerave të tjera të peshës

Printimi i rezultateve duhet të jetë korrekt, i përshtatshëm dhe i pangatërrueshëm për t’u identifikuar. Printimi duhet të jetë i qartë, i lexueshëm, i pafshishëm dhe i qëndrueshëm.

11. Nivelimi

Kur është e nevojshme, peshoret duhet të shoqërohen me pajisje niveluese dhe treguesin e nivelit, të cilët duhet të jenë me ndjeshmëri të mjaftueshme për të lejuar instalimin e kërkuar.

12. Zerimi

Peshoret duhet të pajisen me pajisjet e zerimit. Veprimi i këtyre pajisjeve duhet të bëjë të mundur zerimin e saktë dhe nuk duhet të shkaktojë rezultate matjeje të pasakta.

13. Pajisjet e tarës dhe pajisjet e paravendosjes së tarës

Peshoret mund të kenë një ose më shumë pajisje tare dhe pajisje për paravendosjen e tarës. Veprimi i pajisjes së tarës duhet të bëjë të mundur zerimin e saktë dhe duhet të sigurojë peshimin neto të saktë. Veprimi i pajisjes të paravendosjes së tarës duhet të sigurojë përcaktimin e saktë të vlerës neto të llogaritur.

14. Peshore për shitje direkte në publik me kapacitet maksimal jo më të madh se sa 100 kg; kërkesa shtesë.

Peshoret për shitje direkte në publik duhet të tregojnë të gjithë informacionin më të rëndësishëm rreth veprimit të peshimit dhe në rastin e instrumenteve me çmim-tregues, duhet të tregojnë qartë për konsumatorin çmimin e llogaritur të produktit që blihet.

Çmimi që do paguhet, në qoftë se tregohet, duhet të jetë i saktë.

Peshoret me llogaritje çmimi duhet të shfaqin tregimet më të rëndësishme për një kohë të mjaftueshme, me qëllim që blerësi t’i lexojë ato me lehtësi.

Peshoret me llogaritje çmimi mund të kryejnë funksione të tjera nga ato të peshimit të artikujve dhe llogaritjes së çmimit vetëm në ato raste, kur të gjitha tregimet në lidhje me këto veprime janë të printuara qartë, të pangatërruara dhe të rregulluara përshtatshëm në faturë ose në etiketën për blerësin.

Peshoret nuk duhet të kenë karakteristika, që mund të shkaktojnë, direkt ose indirekt, tregime, interpretimi i të cilave është i vështirë ose jo i drejtpërdrejtë.

Instrumentet duhet të mbrojnë konsumatorin kundrejt transaksioneve dhe shitjeve jo korrekte për shkak të funksionimit jo të mirë të tyre.

Pajisjet treguese ndihmëse dhe pajisjet e tregimit të zgjeruar nuk lejohen.

Pajisje shtesë do të lejohen vetëm nëse ato nuk çojnë në përdorim të gënjeshtërt.

Peshore të ngjashme me ato që përdoren normalisht për shitje direkte në publik të cilat nuk

plotësojnë kërkesat e këtij paragrafi duhet të mbajnë afër treguesit shenjën e paheqshme “I papërdorshëm për shitje direkte në publik”.

15. Peshoret me çmime etiketë

Peshoret me çmim etiketë duhet të plotësojnë kërkesat e instrumenteve me çmim etiketë për shitje direkte në publik, për aq kohë sa ato zbatohen në instrumentin në fjalë. Printimi i etiketës së çmimit poshtë një kapaciteti minimal duhet të jetë i pamundur.

ANEKSI NR.2

PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT

1. Ekzaminimi i tipit CE

1.1 Ekzaminimi i tipit CE është procedura kur një organizëm i autorizuar verifikon dhe certifikon që një peshore, përfaqësuese e prodhimit që shqyrtohet, plotëson kërkesat e këtij vendimi.

1.2 Aplikimi për ekzaminimin-tip duhet të paraqitet nga prodhuesi ose nga importuesi në rastin kur procedura i referohet pikës 9 të vendimit ose nga prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar në rastin kur procedura i referohet pikës 10 me një trupë të autorizuar.

Aplikimi duhet të përmbajë:

- Respektivisht emrin dhe adresën e prodhuesit ose përfaqësuesit të autorizuar, në rastin kur aplikimi paraqitet nga importuesi, emrin dhe adresën e tij si shtesë.

- Një deklaratë me shkrim që aplikimi nuk është paraqitur në ndonjë organizëm tjetër të autorizuar.

- Dokumentacionin teknik, siç përshkruhet në aneksin nr.3 të këtij vendimi.

Aplikuesi duhet të vërë në dispozicion të organizmit të autorizuar një peshore, që përfaqëson prodhimin që shqyrtohet (i cili këtej e tutje do të quhet ‘tip’).

1.3 Organizmi i autorizuar duhet që:

1.3.1 Të ekzaminojë dokumentacionin teknik dhe të verifikojë se tipi është prodhuar në përputhje me këtë dokumentacion.

1.3.2 Të bjerë dakord me aplikantin lidhur me vendin ku do të kryhet ekzaminimi ose testimi.

1.3.3 Të kryejë ose të ketë kryer ekzaminimet ose testet përkatëse për të kontrolluar nëse zgjedhjet e bëra nga prodhuesi plotësojnë kërkesat kryesore dhe nëse standardet e referuara pikës 8 nuk janë zbatuar.

1.3.4 Të kryejë ose të ketë kryer ekzaminimet ose testet përkatëse për të kontrolluar nëse, kur prodhuesi ka zgjedhur për të zbatuar standardet e përshtatshme, këto janë zbatuar me efektivitet.

1.4 Në rastet kur tipi plotëson kërkesat e këtij vendimi, organizmi i autorizuar duhet të lëshojë një certifikatë aprovim-tipi për aplikantin në rast se procedura i referohet pikës 9 ose një certifikatë aprovim-tipi CE në rastin kur procedura i referohet pikës 10. Këto certifikata duhet të përmbajnë konkluzionet e testimeve, kushtet për vlefshmërinë e saj, të dhënat e nevojshme për identifikimin e peshores së aprovuar dhe një përshkrim të funksionimit të saj, që përfshin vizatimet dhe skicat.

Këto certifikata duhet të kenë një periudhë vlefshmërie prej 10 vjetësh që nga data e lëshimit dhe mund të rinovohen për një periudhë të mëpasme prej 10 vjetësh.

Në rastin kur janë bërë ndryshime themelore në konstruksionin e peshores, si p.sh. si rezultat i zbatimit të teknikave të reja, vlefshmëria e certifikatës mund të kufizohet në dy vjet dhe të zgjatet për një periudhë trevjeçare.

1.5 Organizmi i autorizuar duhet të mbajë listën më të fundit të:

- aplikimeve të pranuar për ekzaminim-tipit;
- certifikatat e aprovimit-tipit dhe certifikatat e lëshuara për aprovim-tipi CE;
- aplikimet e refuzuara;
- shtesat dhe amendamentet që lidhen me certifikatat tashmë të lëshuara.

Organizmi i autorizuar duhet për më tepër të informojë menjëherë autoritetet survejuese për tërheqjen e certifikatave të aprovimit-tip dhe certifikatave të aprovimit-tipit CE.

Organizmi i autorizuar duhet ta bëjë këtë informacion të disponueshëm për të tjerë organizma të autorizuar.

1.6 Referuar pikës 10 të vendimit, orgnizmi i autorizuar i notifikuar nga Komuniteti European duhet të marrë të gjitha informacionet e Shteteve Anëtare në përputhje me pikën 1.5 dhe të informojnë menjëherë Shtetet Anëtare për tërheqjen e certifikatave të aprovimit-tipit CE. Organizmat e notifikuara

të Shtetve Anëtare të Komunitetit European mund të marrin një kopje të certifikatave të aprovimit-tip CE së bashku me anekset për ato.

1.7 Aplikanti për çdo modifikim të tipit të aprovuar duhet të mbajë të informuar organizmin e autorizuar, i cili ka lëshuar certifikatën e aprovimit-tipit, në rastin e procedurës që i referohet pikës 9 të vendimit ose ka lëshuar certifikatën e aprovimit-tipit CE, në rastin kur procedura i referohet pikës 10 të vendimit.

Modifikimet e tipit të aprovuar duhet të marrin aprovim shtesë nga organizmi i autorizuar që ka lëshuar certifikatën e aprovimit-tip në rastin kur procedura i referohet pikës 9 të vendimit, në rast se të tilla ndryshime influencojnë në konformitetin me kërkesat kryesore të këtij vendimi ose me kushtet e parashikuara të përdorimit të instrumentit. Ky aprovim jepet në formën e një shtese në certifikatën origjinale të aprovimit-tipit të lëshuar.

2. Deklarimi CE i tipit të konformitetit (garancia e cilësisë së prodhimit)

2.1 Procedura, ku prodhuesi i cili plotëson detyrimet e paragrafit 2.2 deklaron se peshoret përkatëse janë në konformitet me tipin që përshkruhet në certifikatën e aprovimit-tipit, duke përdorur procedurën referuar pikës 9 të vendimit ose në certifikatën e aprovimit-tipit CE duke përdorur procedurën referuar pikës 10, si dhe kënaqin kërkesat e këtij vendimi.

Prodhuesi ose importuesi duhet të shënojë në çdo peshore shenjën shqiptare të konformitetit, kur përdorim procedurën që i referohet pikës 9 të vendimit ose prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar duhet të shënojë shenjën CE në çdo peshore, kur është përdorur procedura që i referohet pikës 10 të vendimit, si dhe përpilon me shkrim një deklaratë të konformitetit.

2.2 Prodhuesi duhet të ketë zbatuar në mënyrë të përshtatshme një sistem cilësie siç specifikohet në paragrafin 2.3 dhe duhet t'i nënshtroheturvejimit të CE siç cilësohet në paragrafin 2.4.

2.3 Sistemi i cilësisë

2.3.1 Prodhuesi duhet të paraqesë aplikimin për aprovimin e sistemit të tij të cilësisë nga organizmi i autorizuar.

Ky aplikim duhet të përmbajë:

- zotimin për plotësimin e detyrave që rrjedhin nga sistemi i cilësisë i aprovuar;
- zotimin për të mbajtur sistemin e cilësisë së aprovuar për të siguruar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e tij të vazhdueshëm.

Prodhuesi duhet të vërë në dispozicion të organizmit të autorizuar të gjitha informacionet e duhura, në veçanti dokumentacionin e sistemit të cilësisë dhe dokumentacionin teknik të peshores.

2.3.2 Sistemi i cilësisë duhet të sigurojë konformitetin e peshoreve me tipin siç përshkruhet në rastin e procedurës që i referohet pikës 9 të vendimit në certifikatën e aprovimit-tipit ose në certifikatën e aprovimit-tipit EC, në rastin e procedurës që i referohet pikës 10 të vendimit, si dhe me kërkesat e këtij vendimi që zbatohet për të.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe kushtet e adaptuara nga prodhuesi duhet të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formë rregullash, procedurash dhe instruksionesh të shkruajtura. Ky dokumentacion i sistemit të cilësisë duhet të sigurojë kuptimin e drejtë të programeve të cilësisë, planeve, manualeve dhe regjistrimeve.

Dokumentacioni duhet të përmbajë në veçanti një përshkrim të përshtatshëm të:

- Objektivave të cilësisë dhe strukturës organizative, fuqisë dhe përgjegjësisë së drejtuesve lidhur me cilësinë e produktit;
- Procesit të prodhimit, kontrollit të cilësisë dhe teknikave të sigurimit dhe matjeve sistematike që duhet të përdoren;
- Ekzaminimet dhe provat që duhet të kryhen para, gjatë dhe pas prodhimit, si dhe frekuencën me të cilën ato do të kryhen;
- Mjetet monitoruese për arritjen e cilësisë së kërkuar të produktit, si dhe veprimin efektiv të sistemit të cilësisë.

2.3.3 Organizmi i autorizuar duhet të ekzaminojë dhe të vlerësojë sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai plotëson kërkesat e dhëna në paragrafin 2.3.2. Ai duhet të presupozojë konformitetin me këto kërkesa për sistemet e cilësisë që zbatohen nga standardet e harmonizuara korresponduese.

Ai duhet t'i njoftojë vendimin e tij prodhuesit dhe të informojë organizmat e tjera përkatëse të autorizuar dhe në rastin e procedurës që i referohet pikës 10 të vendimit, gjithashtu të informojë edhe

organizmat e notifikuar të Komunitetit European. Njoftimi i prodhuesit duhet të përmbajë konkluzionet e ekzaminimit dhe në rast refuzimi, justifikimin e një veprimi të tillë.

2.3.4 Prodhuesi ose importuesi në rast se procedura i referohet pikës 9 të vendimit dhe prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar në rastin kur procedura i referohet pikës 10 të vendimit, duhet të mbajë të informuar organizmin e autorizuar që i ka aprovuar sistemin e cilësisë për çdo azhurnim të sistemit të sigurimit të cilësisë në lidhje me ndryshimet që mund të bëhen p.sh. teknologji të reja apo koncepte të reja cilësie.

2.3.5 Organizmi i autorizuar që tërheq (anulon) aprovimin e sistemit të cilësisë duhet të informojë organizmat e tjera të autorizuar që janë të interesuara dhe në rastin kur procedura i referohet pikës 10 të vendimit, gjithashtu informohen dhe organizmat e notifikuar të Komunitetit European.

2.4 Mbikëqyrja CE

2.4.1 Qëllimi i mbikëqyrjes CE është për t'u siguruar që prodhuesi plotëson rregullisht detyrimet që rrjedhin nga sistemi i cilësisë së aprovuar.

2.4.2 Prodhuesi duhet t'i japë organizmit të autorizuar të drejtën e hyrjes për qëllime inspektimi në sektorët e prodhimit, inspektimit, testimit dhe magazinimit, si dhe duhet t'i paraqesë atij gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti:

- Dokumentacionin e sistemit të cilësisë,
- Dokumentacionin teknik,
- Regjistrimet e cilësisë p.sh. raportet e inspektimit dhe të dhënat e provave dhe kalibrimeve, raportet për kualifikimin e personelit që kanë lidhje me aktivitetin.

Organizmi i autorizuar duhet të kryejë periodikisht kontrolle për t'u siguruar që prodhuesi po mban dhe po zbaton sistemin e cilësisë; ai duhet t'i japë prodhuesit raportin e kontrollit.

Në vazhdim, organizmi i autorizuar mund të kryejë vizita të palajmëruara te prodhuesi. Gjatë këtyre vizitave, organizmi i autorizuar mund të kryejë vëzhgime të plota ose të pjesshme. Ai duhet të sigurojë prodhuesin me një raport mbi vizitën, dhe aty ku është e përshtatshme, një raport për vëzhgimin.

2.4.3 Organizmi i autorizuar duhet të sigurojë që prodhuesi mban dhe zbaton sistemin e cilësisë të aprovuar.

3. Verifikimi CE

3.1 Verifikimi CE është procedura me të cilën prodhuesi ose importuesi, në rastin e procedurës që i referohet pikës 9 të vendimit dhe prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar, në rastin e procedurës që i referohet pikës 10 të vendimit, siguron dhe deklaron që peshoret, të cilat janë kontrolluar në përputhje me pikën 3.3 janë në konformitet me tipin siç përshkruhet procedurat në pikat përkatëse 3 dhe 4 të vendimit të ekzaminimit-tipit dhe të ekzaminimit të tipit EC, si dhe kënaqin kërkesat e këtij vendimi.

3.2 Prodhuesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit të sigurojë konformitetin e peshoreve, aty ku zbatohet, me tipin, siç përshkruhet në certifikatën e ekzaminimit-tipit në rastin kur procedura i referohet pikës 9 të vendimit, ose në certifikatën e ekzaminimit-tipit CE në rastin kur procedura i referohet pikës 10 të vendimit, si dhe me kërkesat e këtij vendimi.

Në rastin kur procedura i referohet pikës 9 të vendimit, prodhuesi ose importuesi duhet të shënojë në çdo peshore shenjën shqiptare të konformitetit, dhe në rast se procedura i referohet pikës 10 të vendimit, prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar duhet të shënojë në çdo peshore shenjën EC, si dhe në të dyja rastet duhet të lëshojë një deklaratë me shkrim të konformitetit.

3.3 Organizmi i autorizuar duhet të kryejë ekzaminimet dhe testet përkatëse në mënyrë që të kontrollojë konformitetin e produktit me kërkesat e këtij vendimi nëpërmjet ekzaminimit dhe testimit të çdo peshoreje, siç specifikohet në pikën 3.5.

3.4 Për peshoret që nuk janë objekt i aprovimit-tipit, dokumentacioni që ka lidhje me konstruksionin e saj, siç referohet në aneksin 3 të këtij vendimi, duhet t'i vihet në dispozicion organizmit të autorizuar deri në ato detaje që ky i fundit e kërkon.

3.5 Verifikimi CE nëpërmjet kontrollit dhe testimit të çdo peshoreje

3.5.1 Të gjitha peshoret duhet të jenë individualisht të ekzaminuara me testet përkatëse, siç janë përcaktuar në standardet përkatëse dhe rregullat e këtij vendimi, ose mund të kryhen teste

ekuivalente në mënyrë që të verifikohet konformiteti i tyre, aty ku zbatohet, me tipin, siç përshkruhet në certifikatën e aprovimit-tipit në rastin kur procedura i referohet pikës 9 të vendimit ose me certifikatën e aprovimit-tipit në rastin kur procedura i referohet pikës 10, si edhe me kërkesat e këtij vendimi.

3.5.2 Organizmi i autorizuar duhet të shënojë ose të ketë shënuar numrin e tij të identifikimit në çdo peshore, konformiteti i së cilës me kërkesat është i vendosur, dhe duke u bazuar në testimin e kryer, lëshon një certifikatë me shkrim që certifikon konformitetin në formën e një akti.

3.5.3 Prodhuesi ose importuesi në rastin kur një procedurë i referohet pikës 9 të vendimit, ose prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar, në rastin kur procedura i referohet pikës 10 të vendimit, duhet të sigurojë që certifikatat e konformitetit të lëshuara nga organizmi i autorizuar duhet të mbështetet nga kërkesa.

4. Verifikimi i njësisë CE

4.1 Verifikimi i njësisë CE është procedura, kur prodhuesi ose importuesi në rastin kur procedura i referohet pikës 9 të vendimit dhe kur prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar, në rastin kur procedura i referohet pikës 10 të vendimit, deklarohet dhe siguron që një peshore, përgjithësisht e konstruktuar për zbatime të veçanta, për të cilin është lëshuar në formën e një akti një certifikatë e shkruajtur që certifikon konformitetin, plotëson kërkesat e këtij vendimi që zbatohen për të.

Në rast se procedura i referohet pikës 9 të vendimit, prodhuesi ose importuesi duhet të shënojë në çdo peshore markën shqiptare të konformitetit, dhe në rast se procedura i referohet pikës 10 të vendimit, prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar duhet të shënojë në çdo peshore shenjën CE, si dhe në të dyja rastet duhet të lëshojë me shkrim deklaratën e konformitetit.

4.2 Organizmi i autorizuar duhet të ekzaminojë peshoren dhe të kryejë provat përkatëse, siç janë përcaktuar nga standardet përkatëse që i referohen këtij vendimi ose prova të barasvlershme, për të siguruar konformitetin e tij me kërkesat përkatëse të këtij vendimi.

Organizmi i autorizuar duhet të shënojë ose të ketë shënuar numrin e tij të identifikimit në çdo peshore, konformiteti i së cilës me kërkesat është i vendosur, dhe duke u bazuar në testimin e kryer, lëshon një certifikatë të shkruar që certifikon konformitetin në formën e një akti.

4.3 Qëllimi i dokumentacionit teknik në lidhje me konstruksionin e peshores, siç referohet në pikën 9 të vendimit është të bëjë të mundur konformitetin me kërkesat e këtij vendimi, duke vlerësuar edhe konstruksionin, prodhimin dhe punën e peshores që është në shqyrtim. Ai duhet të bëhet i pranueshëm dhe t'i vihet në dispozicion organizmit të autorizuar.

4.4 Prodhuesi ose importuesi në rast se procedura i referohet pikës 9 të vendimit ose prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar, në rastin kur procedura i referohet pikës 10 të vendimit duhet të sigurojë që certifikatat e konformitetit të lëshuara nga organizmi i autorizuar jepen mbi bazën e kërkesës.

5. Parime të përgjithshme

5.1 Deklarimi CE i tipit të konformitetit (garancia e cilësisë së prodhimit), verifikimi i CE, dhe verifikimi i njësisë CE mund të kryhen në vendin e punës së prodhuesit ose në ndonjë vend tjetër, në qoftë se transporti në vendin e përdorimit të mos kërkojë çmontimin e peshores, në qoftë se vënia në punë në vendin e përdorimit të mos kërkojë montimin e peshores ose punë të tjera teknike instalimi, të cilat mund të ndikojnë në funksionimin e saj ose në qoftë se funksionimi peshores është i pandjeshëm ndaj ndryshimeve të gravitetit. Në të gjitha rastet e tjera ato duhet të kryhen në vendin e përdorimit të peshores.

5.2 Në qoftë se peshorja është e ndjeshme ndaj ndryshimit të gravitetit, procedurat e referuara në pikën 5.1. mund të kryhen në dy etapa, ku etapa e dytë duhet të përfshijë të gjitha ekzaminimet dhe provat, rezultati i të cilave është i varur nga graviti, dhe etapa e parë të gjitha ekzaminimet dhe provat e tjera.

Etapa e dytë duhet të kryhet në vendin e përdorimit të peshores. Nëse Republika Shqipërisë i ka caktuar zonat e gravitetit në territorin e saj, shprehja “në vendin e përdorimit të peshores” mund të lexohet si “në zonën e gravitetit ku përdoret peshorja”.

5.3.1 Aty ku prodhuesi ka zgjedhur ekzekutimin në dy etapa të njërës nga procedurat e përmendura në pikën 5.1, dhe kur këto dy etapa kryhen nga organizma të autorizuar të ndryshëm, dhe peshorja e cila i është nënshtruar etapës së parë të procedurës në fjalë duhet të mbajë numrin e identifikimit të organizmit të autorizuar që është përfshirë në etapën e parë.

5.3.2 Organizmi i autorizuar që kryen etapën e parë të procedurës duhet të lëshojë për çdo

peshore një certifikatë që përmban të dhënat e nevojshme për identifikimin e saj dhe të specifikojë ekzaminimet dhe provat që janë kryer.

Organizmi i autorizuar që kryen etapën e dytë të procedurës duhet të kryejë ato ekzaminime dhe prova që nuk janë kryer akoma.

Prodhuesi ose importuesi në rastin kur procedura i referohet pikës 9 të vendimit dhe prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar në rastin kur procedura i referohet pikës 10 të vendimit duhet të sigurohet që të jetë i aftë për ta pajisur me certifikatën e konformitetit të lëshuar nga organizmi i notifikuar kur kërkohet.

5.3.3 Prodhuesi i cili ka zgjedhur etapën e parë për deklarin EC të konformitetit tipit (garancia e cilësisë së prodhimit) mund të përdorë të njëjtën procedurë në etapën e dytë ose të vendosë për verifikimin EC.

5.3.4 Me përfundimin e etapës së dytë do shënohet në peshore marka shqiptare e konformitetit, në rastin kur procedura i referohet pikës 9 të vendimit ose shenja CE, në rast se procedura i referohet pikës 10 të vendimit, së bashku me numrin e identifikimit të organizmit të autorizuar, i cili ka kryer etapën e dytë.

ANEKSI NR.3 DOKUMENTACIONI TEKNIK

Dokumentacioni teknik duhet ta bëjë projektin dhe përdorimin e instrumentit të kuptueshëm dhe të bëjë të mundur vlerësimin e peshores nëse ajo plotëson kërkesat e këtij vendimi.

Dokumentacioni për vlerësim duhet të përfshijë:

- Një përshkrim të përgjithshëm të tipit;
- Projektet konceptuale, vizatimet e prodhimit dhe skicat e komponentëve, të montimeve dhe të qarqeve;
- Përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për kuptimin e dokumenteve të mësipërme, duke përfshirë dhe funksionimin e peshores;
- Një listë të standardeve që referohen këtij vendimi, që zbatohet plotësisht ose pjesërisht, si dhe përshkrimet e zgjidhjeve të adaptuara për të plotësuar kërkesat kryesore, aty ku standardet që i referohen këtij vendimi nuk duhet të zbatohen;
- Rezultatet e llogaritjeve projektuese, ekzaminimet;
- Raportet e testimit;
- Certifikatat e aprovimit-tipit, në rast se procedura i referohet pikës 9 të vendimit ose certifikatat e aprovimit-tipit CE, në rast se procedura i referohet pikës 10 të vendimit, së bashku me rezultatet e testimeve përkatëse me instrumentet që kanë pjesë identike me ato të konstruksionit.

ANEKSI NR.4

SHËNIMET MBI PESHORE

1. Peshoret që i nënshtrohen procedurës së vlerësimit të konformitetit

1.1 Këto peshore duhet të kenë të shënuar:

a) Në rast se procedura i referohet pikës 9 të vendimit markën shqiptare të konformitetit të ndjekur nga dy shifrat e fundit të vitit kur ajo është vendosur ose kur procedura i referohet pikës 10 të vendimit shenjën CE të ndjekur nga numri identifikimit të organizmit të autorizuar dhe nga dy shifrat e fundit të vitit në të cilin kjo shenjë është vendosur;

Shenjat e përmendura më lart duhet të ngjiten në instrument të grupuara në mënyrë të qartë;

b) Një letër ngjitëse me ngjyrë jeshile, në formë katrore me përmasa minimale 12.5 mm x 12.5 mm, që ka të shënuar me ngjyrë të zezë germën 'M' të madhe të shtypit;

c) Mbishkrimet e mëposhtme:

Numri i certifikatës së aprovimit-tipit, në rast se procedura i referohet pikës 9 të

vendimit ose numrin e certifikatës aprovimit-tipit CE, në rast se procedura i referohet pikës 10 të vendimit;

Shenjën ose emrin e prodhuesit;

Klasën e saktësisë, brenda një ovaleje ose brenda dy vijave horizontale që bashkohen me dy gjysmë-rrathë;

Kapacitetin maksimal në formën Max;

Kapacitetin minimal në formën Min ...;

Ndarjen e verifikuese të shkallës në formën $e = \dots$;

Si dhe kur është e zbatueshme:

Numrin e serisë.

Për peshoret që përbëhen nga njësi të ndara, por që grupohen: shenjën identifikuese të secilës njësi,

Ndarjen e shkallës në qoftë se ajo është e ndryshme nga e , në formën $d = \dots$,

Efektin e tarës shtesë maksimale, në formën $T = + \dots$,

Efektin maksimal të tarës zbritëse në qoftë se ai është i ndryshëm nga ai maksimali, në formën $T = - \dots$,

Ngarkesën maksimale të sigurisë në qoftë se ajo është e ndryshme nga Max, në formën Lim...,

Ndarja e tarës në qoftë se ajo është e ndryshme nga d , në formën $dT = \dots$,

Kufijtë specifikë të temperaturës, në formën $\dots \text{ }^{\circ}\text{C} / \dots \text{ }^{\circ}\text{C}$,

Raportin ndërmjet marrësit të ngarkesës dhe ngarkesës.

1.2 Peshoret duhet të krijojnë mundësinë për ngjitjen e shenjave. Këto duhet të jenë të tilla që heqja e tyre të jetë e pamundur pa dëmtimin e tyre, dhe mbishkrimet duhet të jenë të dukshme kur peshorja është në pozicion të rregullt pune.

1.3 Aty ku përdoret pllakë të dhënash, ajo duhet të bëjë të mundur vulosjen e pllakës në mënyrë që të mos bëhet heqja e saj pa u shkatërruar. Në rast se pllaka e të dhënave është e ngjithshme duhet të krijojë mundësinë për vendosjen e shenjës së kontrollit në të.

1.4 Përshkrimet Max, Min, e , d , duhet të shfaqen pranë tregimit të rezultatit nëse ato nuk janë vendosur në pllakën e të dhënave.

1.5 Çdo pajisje matëse e ngarkesës që është e lidhur ose mund të lidhet me një ose disa marrës ngarkese duhet të mbajë mbishkrimet përkatëse që kanë lidhje me këta marrës ngarkese.

2. Peshoret e tjera

Peshoret duhet të mbajnë:

- Emrin ose shenjën e prodhuesit,

- Kapacitetin maksimal në formën Max ...,

Këto peshore mund të mos mbajnë etiketë ngjitëse siç jepet në pikën 1.1. (b).

3. Shenja e përdorimit të kufizuar

Kjo shenjë përbëhet nga germa e madhe 'M', e printuar me ngjyrë të zezë në një katror me sfond të kuq me madhësi të paktën 25 mm x 25 mm, me dy diagonale që ndërpriten në formë kryqi.

ANEKSI NR.5

KËRKESAT MINIMALE QË DUHET TË ZBATOHEN KUR EMËROHET ORGANIZMI I AUTORIZUAR

Këtu më poshtë janë dhënë kërkesat kryesore që i referohen nenit 5 të ligjit nr.9097, datë 3.7.2003 "Për vlerësimin e konformitetit":

1. Aplikanti duhet të ketë personelin, mjetet dhe pajisjet e nevojshme.

2. Personeli duhet të ketë kompetenca teknike dhe pavarësi profesionale.

3. Kur kryhen testimet, përgatiten raportet, lëshohen certifikatat dhe në rastin e vëzhgimit që kërkohet nga ky vendim, aplikanti duhet të punojë i pavarur në çdo rrethanë, nga grupet ose personat që kanë interesa direkt ose indirekte në peshoret e përcaktuara në këtë vendim.

4. Personeli duhet të respektojë sekretin profesional duke respektuar çështjet në lidhje me aktivitetet e trupës së autorizuar.

5. Aplikanti duhet të nxjerrë sigurimin e përgjegjësisë civile për dëmtimin.


6. Plotësimi i konditave në pikën 1 dhe 2 duhet që periodikisht të verifikohet nga ministria

përkatëse që ka propozuar për emërimin.

ANEKSI NR.6

SHENJA E KONFORMITETIT – CE

Shenja e konformitetit – CE përbëhet nga shkronjat “CE”, siç është paraqitur më poshtë:



- Zvogëlimi apo zmadhimi i shenjës – CE duhet të bëhet proporcionalisht në të gjithë hapësirën.
- Elementet e veçanta të shenjës – CE duhet të kenë të njëjtën lartësi; lartësia minimale e germave është 5mm.

UDHËZIM Nr.1468, datë 26.6.2006

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 223, DATË 19.4.2006 "PËR PAGESËN E TË ARDHURËS NGA PAPUNËSIA"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të pikës 12 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.223, datë 19.4.2006 “Për pagesën e të ardhurës nga papunësia”, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

UDHËZON:

1. Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.223, datë 19.4.2006 “Për pagesën e të ardhurës nga papunësia”, për të përfutur të ardhurën nga papunësia personat duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

2. Në personat të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi përfshihen dhe:

a) Ushtarët e liruar nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak, të cilët detyrimisht para kryerjes së këtij shërbimi kanë qenë të siguar për përfitim të të ardhurës nga papunësia për periudhën 12-mujore dhe ndërprerjen e punës e kanë për shkak të fillimit të këtij shërbimi.

b) Gratë të cilat përfundojnë trajtimin me të ardhurën e barrë lindjes (jo më parë se 42 ditë pas lindjes), dhe në momentin që kthehen në vendin e punës, ju ndërpritet marrëdhënia individuale e punës, të cilat detyrimisht kanë qenë të siguruara për përfitim të të ardhurës nga papunësia për periudhën 12-mujore përpara fillimit të përfitimit të të ardhurës për barrë lindje.

c) Ushtarakët e liruar nga detyra dhe që nuk përfitojnë nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

d) Personat të cilët janë shkëputur nga puna për arsye të përfitimit të paafetësisë së përkohshme dhe

pas mbarimit të kësaj periudhe në momentin që kthehen në vendin e punës, u ndërpritet marrëdhënia individuale e punës, të cilët detyrimisht kanë qenë të siguruar për përfitim të të ardhurës nga papunësia për periudhën 12 -muajore përpara fillimit të përfitimit të paaftësisë së përkohshme në punë.

3. Të ardhurën nga papunësia nuk e përfitojnë personat të cilët:

- a) janë në marrëdhënie pune;
- b) janë punëdhënës dhe të vetëpunësuar në qytet ose në fshat;
- c) janë duke vuajtur dënimin me heqje lirie;
- d) janë në përfitim pensioni pleqërie, invaliditeti apo familjar, përfitim paaftësie të përkohshme në punë, përfitim të ardhurë barrë lindje, përfitim nga aksident në punë apo sëmundje profesionale, përfitim ndihmë ekonomike;

e) pa argumente të arsyeshme, nuk kanë pranuar të ndjekin programe punësimi, me pagesë të ofruara nga zyrat e punësimit, për aq kohë sa zgjasin këto programe punësimi.

4. Për të përfituar të ardhura nga papunësia, personat duhet:

a) të paraqesin në Zyrën e Punësimit kërkesën me shkrim dhe dokumentacionin e përcaktuar në pikën 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.223, datë 19.4.2006 “Për pagesën e të ardhurës nga papunësia”,

b) kërkesa të plotësohet brenda 60 ditëve nga dita e lindjes të së drejtës së përfitimit të këtyre të ardhurave që konsiderohet dita e parë e mbetjes i papunë,

c) të konfirmohen të regjistruar si punëkërkues të papunë, në rast të kundërt ata humbasin të drejtën e përfitimit të të ardhurës nga papunësia me përjashtim të rasteve kur janë të paaftë për punë, paaftësi e vërtetuar me raport mjeko-ligjor.

5. Për çdo rast përfitimi personat duhet të kenë gjithsej 12 muaj pagesë kontributesh të sigurimeve shoqërore në degën e sigurimit të papunësisë.

Personat që kanë plotësuar kushtet për të ardhurën e papunësisë pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.223, datë 19.4.2006 “Për pagesën e të ardhurës nga papunësia”, do të konsiderohet si kërkesë për herë të parë për të përfituar të ardhurën nga papunësia, pra përfitimi do të jetë 12 muaj.

Në rast të paraqitjes së një kërkesë të dytë brenda periudhës së përcaktuar në germen “b” të pikës 2 të vendimit, pasi të kenë derdhur kontribut për një periudhë prej 12-muajsh, përfitimi i të ardhurës nga papunësia do të jetë 10 muaj.

Në rast të paraqitjes së një kërkesë të tretë brenda periudhës së përcaktuar në germen “c” të pikës 2 të vendimit, pasi të kenë derdhur kontribut për një periudhë prej 12-muajsh, përfitimi i të ardhurës nga papunësia do të jetë 8 muaj.

Për kërkesat e paraqitura në kushtet e germës “d” të pikës 2 të vendimit, kërkesa do të konsiderohet si e paraqitur për herë të parë dhe përfitimi do të jetë 12 muaj.

6. Në zbatim të pikës 3 të vendimit personat të cilët aplikojnë për të përfituar të ardhurën nga papunësia, përveç dokumenteve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.223, datë 19.04.2006, duhet të plotësojnë edhe formularin e dyfishtë dhe deklaratën e kompensimeve, të cilat i vihen në dispozicion nga zyra kompetente e punësimit.

7. Fëmijët që janë në ngarkim të personit i cili do të përfitojë të ardhurën nga papunësia, të cilët janë mbi moshën 16 vjeç (mosha minimale sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë), do të pasqyrohen në deklaratën e kompensimeve, nëse janë regjistruar si punëkërkues të papunë dhe kjo të jetë vërtetuar nga sektori i shërbimeve të zyrës kompetente të punësimit.

8. Fëmijët që janë në ngarkim të personit i cili do të përfitojë të ardhurën nga papunësia, të cilët janë duke ndjekur shkollën deri në moshën 18 vjeç ose kur ata studiojnë ose janë të paaftë për punë deri në moshën 25 vjeç, do të pasqyrohen në deklaratën e kompensimeve, pa qenë e nevojshme të jenë të regjistruar si punëkërkues të papunë.

9. Në rastet e punësimit gjatë periudhës së përfitimit të të ardhurës nga papunësia apo gjatë periudhës së kualifikimit/rikualifikimi (me pagesë), e ardhura e papunësisë merret me ndërprerje për një periudhë deri në dy vjet, por me kusht që të mos merren më shumë se 365 ditë kalendarike gjithsej për përfitim për herë të parë, 304 ditë gjithsej për përfitim për herë të dytë dhe 243 ditë gjithsej për përfitim për herë të tretë.

10. Përfituesi i të ardhurës nga papunësia është i detyruar të paraqitet në Zyrën e Punësimit, një herë në muaj (ndër të tjera për të tërhequr edhe kuponin e pagesës së papunësisë) ose sa herë që thirret nga kjo zyrë.

11. Rastet e përligjura që përfituesi është i justifikuar për mosparaqitje janë:

- a) sëmundje e vërtetuar me raport mjeko-ligjor;

- b) vdekja e një pjesëtari të familjes e vërtetuar me certifikatë vdekje;
- c) largim jashtë vendit për një periudhë prej një muaji, vërtetuar me pasaportën me të cilën është kryer udhëtimi;
- d) ndalim nga organet e drejtësisë;
- e) thirrja nga dega ushtarake për shërbimin e detyrueshëm ushtarak.

12. Për të gjitha rastet e lartpërmendura e ardhura nga papunësia do të arkëtohet deri në një muaj, e cila derdhet në Buxhetin e Shtetit dhe është e pakthyeshme për klientin në rastet e pajustificuara.

13. E ardhura nga papunësia caktohet mujore dhe paguhet përpjestimisht me numrin e ditëve kalendarike, për kohën që përfituesi ka të drejtë ta marrë këtë të ardhur. Pagesa jepet një herë në muaj pranë Alba-Postës në bazë të marrëveshjes së datës 23.5.2001 ndërmjet Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe Alba-Post sh.a., në datat e caktuara. Ajo i jepet vetëm personit përfitues, duke u paraqitur pranë arkës me dokumentin e identifikimit.

14. Periudha gjatë së cilës përfituesi merr të ardhura nga papunësia njihet vjetërsi pune e siguruar për efekt pensioni pleqërie, familjar dhe invaliditeti dhe si e tillë pasqyrohet në librezën e tij të punës.

15. Përfituesit kanë të drejtë të marrin kompensimet në vlerë për rritjen e çmimeve të ushqimeve sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.310, datë 24.7.1992, pika 1/2, germa "a", kompensimin nga rritja e çmimit të bukës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.247, datë 12.6.1993 pika 1/7, si dhe kompensimin nga rritja e çmimit të energjisë elektrike sipas pikës 1/2, germa "b", dhe 1/7 (Të gjitha këto përcaktohen në udhëzimet përkatëse të dërguara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale & Shanseve të Barabarta).

16. Personat që punësohen me ndërprerje gjatë periudhës 12-mujore, 10-mujore dhe 8-mujore të përfitimit të të ardhurës nga papunësia, përfitojnë nivelin e të ardhurës nga papunësia, të periudhës në të cilën ata rifuten në skemë.

17. Personat që ndjekin kurse kualifikimi dhe rikualifikimi, përfitojnë të ardhura nga papunësia gjatë gjithë kohës së zhvillimit të kurseve, në rast se nuk paguhet nga ndonjë burim tjetër për këtë periudhë.

18. Përfituesit me fëmijë në ngarkim deri në moshën 18 vjeç dhe 25 vjeç, sipas pikës 3/d dhe 3/dh, do të marrin një shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5 për qind të të ardhurave mujore nga papunësia (niveli bazë i pagesës), por jo më tepër se 30 për qind për të gjithë fëmijët në ngarkim.

19. Kur të dy prindërit përfitojnë të ardhura nga papunësia, shtesën familjare në masën 5% do ta marrë kryesisht kryefamiljari (ose dhe mund të ndahet midis përfituesve). Kur njëri nga prindërit është në marrëdhënie pune ose merr pension të plotë, shtesa familjare përgjysmohet (d.m.th. 2.5 % për çdo fëmijë deri 18 vjeç dhe 25 vjeç në ngarkim, por jo më shumë se 15 për qind për të gjithë fëmijët në ngarkim).

20. Kur prindërit janë të divorcuar me vendim gjykatë, shtesën familjare e merr prindi që e ka fëmijën në ngarkim. Në rast se gjatë kohës së përfitimit të të ardhurave nga papunësia personi largohet me banim në një vend tjetër, me kërkesën e tij zyra e punësimit të rrethit ku ai banon dërgon zyrtarisht dosjen me dokumentacionin përkatës në zyrën e punësimit të rrethit ku ai është transferuar.

21. Në rastet ku personat përfitues të të ardhurave nga papunësia ndryshojnë vendbanimin apo kur qendra e fundit e punës i përket zonës së një zyre tjetër kompetente punësimi, ata janë të detyruar të fillojnë procedurat dhe caktimi i përfitimit të pagesës së papunësisë bëhet në zyrën e punësimit të rrethit ku ndodhet qendra e punës, e cila pasi paguan përfitimin për një muaj, me kërkesë të personit të interesuar bën transferimin zyrtar të dosjes me dokumentacionin përkatës.

22. Për efekt të zbatimit të vendimit, punësim i përshtatshëm konsiderohet punësimi i paguar, i një personi, në përputhje me: moshën, gjininë, kushtet shëndetësore, arsimimin, formimin profesional, vendbanimin, kohëzgjatjen e punësimit të mëparshëm, përvojën e fituar, ndikimin e punës në fjalë në gjendjen personale dhe familjare dhe situatën e tregut të punës.

23. Udhëzimi nr.1, datë 13.5.1999 shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Koço Barka

VENDIM

Nr.464, datë 29.06.2006

**PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT
“BLUE SKY”
SUBJEKTIT FIZIK: GËZIM BRAHUSHA**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim rtv analogjik tokësor në nivel vendor” të miratuar me vendimin nr. 355, pika 1, datë 29.08.2005 të KKRT-së, të vendimit nr. 444, datë 21.03.2006 të KKRT-së “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radio e televizivë”, si dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” të miratuar me vendimin nr. 375, datë 30.11.2005 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit fizik z. Gëzim Brahusa licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve televizive analogjike tokësore, për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Shkodrës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Halil Lalaj**

**VENDIM
Nr.465, datë 29.06.2006**

**PËR MOSDHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT
“GOLD”**

PERSONIT FIZIK: z. ZAMIR SPATHARA

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim rtv analogjik tokësor në nivel vendor” të miratuar me vendimin nr.355, datë 29.08.2005 të KKRT-së, të vendimit nr.444, datë 21.03.2006 të KKRT-së “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radio e televizivë”, si dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin e KKRT-së nr.375, datë 30.11.2005, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. Të mos i japë licencë subjektit fizik, z.Zamir Spathara për televisionin vendor privat “GOLD”, pasi në dokumentacionin e paraqitur mungon:

- kapitali themeltar i shoqërisë është paraqitur në formë të aseteve sipas raport vlerësimit për asete që janë jashtë veprimtarisë rtv (në kundërshtim me nenin 20 të ligjit nr.8410).

2. Subjekti sipas pikës 1 të vendimit, mund të ankohet në Gjykatën e Shkallës Parë Tiranë, në

përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.466, datë 29.06.2006

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RADIO VENDORE PRIVATE
“LOGOS”

SUBJEKTIT FIZIK: GEORGE STURM

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim rtv analogjik tokësor në nivel vendor” të miratuar me vendimin nr. 355, pika 1, datë 29.08.2005 të KKRT-së, të vendimit nr.444, datë 21.03.2006 të KKRT-së “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radio e televizivë”, si dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” të miratuar me vendimin nr. 375, datë 30.11.2005 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit fizik, z. George Sturm licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Pogradecit.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.467, datë 29.06.2006

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT

“FOKUS”

SUBJEKTIT JURIDIK: SHOQËRIA “FOKUS TV” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim rtv analogjik tokësor në nivel vendor” të miratuar me vendimin nr.355, pika 1, datë 29.08.2005 të KKRT-së, të vendimit nr.450, datë 27.04.2006 të KKRT-së “Për organizimin e konkurrit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radio e televizivë”, si dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” të miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit juridik, shoqërisë “Fokus TV” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve televizive analogjike tokësore, për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Vlorës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM

Nr.468, datë 29.06.2006

PËR MOSDHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “TV HIMARA”

SHOQËRISË: “JON IMPEKS” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.375, datë 30.11.2005, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll” të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.03.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. Të mos i japë licencë subjektit juridik, shoqërisë “Jon Impeks” sh.p.k., për televizionin kabllor privat “TV Himara”, pasi:

- Objekti i veprimtarisë së shoqërisë që aplikon nuk është ekskluziv për veprimtari rtv (neni 20 i ligjit);

- Mungon kapitali themeltar;

- Mungon plani ekonomiko-financiar për periudhën e vlefshmërisë së licencës.

2. Subjekti, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka të drejtën e ankimit në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.469, datë 29.06.2006

PËR MOSDHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT
“ERZENI”

PERSONIT FIZIK: z.SHKËLQIM BËRHAMI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin e KKRT-së nr.375, datë 30.11.2005, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll” të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.03.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. Të mos i japë licencë subjektit fizik, z. Shkëlqim Bërhami për televizionin kabllor privat “ERZENI”, pasi në dokumentacionin e paraqitur mungojnë:

- kapitali themeltar,
- plani ekonomik-financiar për periudhën e vlefshmërisë së licencës,
- garancia bankare për transmetim radioteleviziv,
- plani i implementimit të projektit, afatin e parashikuar të daljes në transmetim pas marrjes së licencës dhe afatin e instalimit të kapacitetit të plotë.

2. Subjekti, sipas pikës 1 të vendimit, mund të ankohet në Gjykatën e Shkallës Parë Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr. 470, datë 29.06.2006

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT
“ALB-WEST”

SUBJEKTIT JURIDIK: SHOQËRIA “ALBANIA BY ATY” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim rtv analogjik tokësor në nivel vendor” të miratuar me vendimin nr.355, pika 1, datë 29.08.2005 të KKRT-së, të vendimit nr.450, datë 27.04.2006 të KKRT-së “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radio e televizivë”, si dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” të miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit juridik, shoqërisë “Albania By Aty” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve televizive analogjike tokësore, për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Vorës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM

Nr.471, datë 29.06.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK ME PËRSËRITËS “RADIO ITALIA”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të nenit 113 pika c të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr. 002/PPH, të rinovojë për një afat të ri 4 vjeçar për ritransmetimin e programeve të huaja radio me përsëritës shoqërinë “ABS” sh.p.k. për “Radio Italia”.

2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.

3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 13.08.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM

Nr.472, datë 29.06.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV MIRDITA”

Në mbështetje të pikës 21 të nenit 7, neneve 22 dhe 30 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të nenit 112, pika 2/a të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.048/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5 vjeçar në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, shoqërinë “Reçi KGM” sh.p.k. për televizionin vendor privat “TV Mirdita”.
2. Të miratojë ndryshimet e të dhënave të paraqitura në kërkesën për rinovimin e licencës nga ana e televizionit vendor “TV Mirdita”.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi në datën 19.06.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.473, datë 29.06.2006

PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT TË SUBJEKTIT TELEVIZIV KABLLOR
PRIVAT “KUKËSI”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, vendimit të KKRT-së nr.297, datë 22.12.2004, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll” të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.03.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të shoqërisë “Televizioni Kukësi” sh.a. për televizionin kabllor privat “Kukësi”, me nr. licence 031/RTVK në qytetin e Krumës.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatese dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për veprime të mëtejshme.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.480, datë 29.06.2006

MBI PAVLEFSHMËRINË E LICENCËS SË TV VENDOR “ANTENA JUG”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Halil	Lalaj	Kryetar
Sefedin	Çela	Anëtar
Albert	Minga	Anëtar
Visar	Zhiti	Anëtar
Agim	Duro	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi licencën e subjektit televiziv vendor TV Antena Jug.

SUBJEKT I INTERESUAR: TV Antena Jug, në mungesë.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullorja “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, dhe vendimet nr.438, datë 21.3.2006 dhe nr.459, datë 11.5.2006 të KKRT-së,

VËREN:

Në datën 3.1.2006 ka përfunduar afati i licencimit të subjektit televiziv TV Antena Jug, të licencuar me vendimin nr. 29, datë 30.10.2000 të KKRT-së. Sipas licencës nr.034/TVL, zona e licencimit të këtij subjekti është pjesërisht rrethi Gjirokastrë.

KKRT ka njoftuar zyrtarisht këtë subjekt në datën 11.10.2005 me shkresën nr.770 prot., duke i caktuar datën 11 nëntor 2005 si afat për paraqitjen e kërkesës dhe dokumentacionit për rinovimin e licencës. Nëpërmjet këtij njoftimi, KKRT i ka bërë të ditur subjektit TV Antena Jug, një sërë kriteresh që do të merren parasysh gjatë vlerësimit të kërkesave për rinovimin e licencave, në përputhje me pikën 4 të rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së. Kjo rregullore i është dërguar zyrtarisht subjektit me shkresën nr.770, datë 11.10.2005.

KKRT, me shkresën nr.770/2, datë 14.11.2005 ka rikujtuar subjektin për përfundimin e afatit të licencës, duke e shtyrë njëkohësisht afatin e depozitimit të dokumentacionit për rinovim licence deri në datën 5.12.2005.

Në mbarim të afatit të licencimit, duke qenë se subjekti nuk paraqiti dokumentacionin për rinovim licence, pra nuk shfaqti interes për rinovimin e licencës, në mbështetje të neneve 25, 33 pika 1 dhe 137/3, si dhe të “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, me vendimin nr.438, datë 21.3.2006 vendosi paraprakisht të mos i rinovojë licencën subjektit televiziv TV Antena Jug. Ky vendim i është përcjellë subjektit me shkresën nr. 213 prot, datë 23.3.2006.

Sipas pikës 1 të vendimit të mësipërm, subjektit iu la ka të drejtë që brenda një afati prej 30 ditësh të parashtrojë pretendimet e tij lidhur me këtë vendim. Nga ana e subjektit nuk u paraqit asnjë pretendim dhe as dokumentacion për rinovim licence, me gjithë komunikimin në mënyrë të herëpashershme, nëpërmjet shkresave zyrtare dhe me telefon.

Në mbledhjen e KKRT-së të datës 11.05.2006, për të cilën subjekti ishte njoftuar për pjesëmarrje për të dhënë pretendimet e tij para marrjes së vendimit përfundimtar, KKRT, pasi dëgjoi pretendimet e përfaqësuesit të TV “Antena Jug”, vendosi me vendimin nr.459 të shtyjë afatin për depozitimin e dokumentacionit për rinovim licence për subjektin TV Antena Jug, duke caktuar datën 10 qershor 2006 si afat të fundit.

Subjekti është njoftuar për këtë vendim me shkresën nr.416, datë 15.05.2006 dhe megjithë kalimin e afatit nuk ka paraqitur asnjë pretendim dhe as dokumentacion për rinovim licence.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit vëren se nga ana e subjektit nuk është respektuar ligji dhe aktet e miratuara nga KKRT.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të neneve 7 pika 21, 25, 33 pika 1 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, të vendimeve nr.438, datë 21.03.2006 dhe nr. 459, datë 11.05.2006 të KKRT-së, pasi dëgjoi pretendimet e përfaqësuesit të TV “Antena Jug”,

VENDOSI:

1. Nuk rinovohet licenca nr. 034/TVL dhënë shoqërisë “Antena Jug” sh.p.k. për TV “Antena Jug”.

2. Licenca, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet e pavlefshme.

3. Subjekti “Antena Jug” sh.p.k. është i detyruar ta ndërpresë transmetimin.

4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

5. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.482, datë 29.06.2006

MBI REDUKTIMIN E KOHËS SË VLEFESHMËRISË SË LICENCËS SË TV “ABC”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Halil	Lalaj	Kryetar
Sefedin	Çela	Anëtar
Albert	Minga	Anëtar
Visar	Zhiti	Anëtar
Agim	Duro	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Për pavlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv vendor privat “TV abc”.

SUBJEKT I INTERESUAR: TV “abc”, në mungesë.

BAZA LIGJORE: Ligji nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” neni 7, pika 21, neni 33, pika 5, si dhe vendimi nr.371, datë 10.11.2005 i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit,

VËREN:

Me vendimin nr.210, datë 30.1.2004, KKRT ka licencuar për një afat 5-vjeçar z. Armand Baze për televizionin vendor privat TV abc me nr. licence 064/TVL, datë 6.2.2004.

Me vendimin nr.371, datë 10.11.2005 “Mbi vlefshmërinë e licencës së disa subjekteve rtv private”, pika 1/1, KKRT, pasi dëgjoi edhe pretendimet e paraqitura nga z. Armand Baze, ka bërë të pavlefshme licencën e subjektit televiziv vendor privat TV abc, për shkak se nuk ka shlyer pagesën vjetore të licencës për vitin 2004 në shumën 91.5 mijë lekë.

Pas njohjes me këtë vendim, i cili linte një afat prej 30 ditësh për paraqitjen e mendimit nga ana e subjektit, në datën 9.2.2006 pronari i TV abc ka dërguar një fax, sipas të cilit: “...frekuenca e akorduar për TV abc është e okupuar nga një stacion tjetër. TV abc vazhdon të jetë pa transmetim”.

KKRT konstaton se:

- argumenti i paraqitur nga subjekti nuk ka lidhje me shkakun për të cilin është marrë vendimi nr.371, datë 10.11.2006 i KKRT-së;

- subjekti TV “abc” nuk ka shlyer pagesën vjetore të licencës për vitin 2004 në shumën 91.5 mijë lekë;

- subjekti TV “abc” nuk ka shlyer pagesën vjetore të licencës për vitin 2005 në shumën 71.5 mijë lekë dhe taksën për përdorim frekuence në shumën 96 mijë lekë.

Në mbledhjen e datës 21.03.2006, KKRT, pasi dëgjoi pretendimet e përfaqësuesit të TV “abc”, i la si detyrë këtij të fundit të formatojë një kërkesë me shkrim ku:

a) të pohohet gatishmëria që brenda 6-mujorit të parë të vitit 2006 të shlyejë detyrimet

financiare të vitit 2004 dhe brenda 6-mujorit të dytë detyrimet për vitet 2005-2006;

b) të deklarohet tërheqja nga zona që TV “abc” ka të miratuar me licencë me qëllim zvogëlimin e tarifave.

Nga ana e subjektit nuk ka pasur asnjë reagim apo pretendim për këto detyra të ngarkuara nga Këshilli.

KKRT vëren se në mbështetje të nenit 33 pika 5 të ligjit nr.8410, datë 30.09.1998, “Licenca bëhet e pavlefshme kur...5. kërkuar...nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj...”.

Gjithashtu, në mbështetje të nenit 7 të ligjit nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, “Taksa vjetore është e menjëhershme dhe paguhet brenda 3 mujorit të parë të vitit në vazhdim”.

Ndërkohë, neni 34 pika 2 e ligjit, parashikon që “Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka të drejtë të heqë licencën e transmetimit kur:... nuk plotësohen kushtet për të cilat është dhënë licenca...”. Në kushtet e licencës nr. 064/TVL që i është dhënë personit fizik z. Armand Baze, në pikën 12/b përcaktohet: “Pagesat që i licencuari i bën KKRT-së janë si vijon :...b) pagesa vjetore prej 71 500 lekësh për vitet e tjera të vlefshmërisë së licencës... për çdo tremujor, brenda datës 15 të muajit të dytë pasardhës”.

Siç rezulton, nga ana e subjektit televiziv « abc » nuk janë respektuar kërkesat e ligjit dhe kushtet e licencës. Konkretisht, nga ana e subjektit nuk është respektuar neni 33 pika 5 e ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe kushtet e licencës nr. 064/TVL, pika 12, paragrafi b.

Në mbështetje të nenit 56/a,b të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit “Palët e interesuara duhet të njoftohen për të gjitha aktet administrative nëpërmjet të cilave merren vendime në lidhje me pretendimet e tyre”, subjekti TV “abc” është njoftuar me shkresën nr. 541 prot., datë 27.6.2006.

PËR KËTO ARSYE,

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” neni 7, pika 21, neni 33, pika 5, neni 137/3 pika b, si dhe vendimit nr.371, datë 10.11.2005, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të reduktojë kohën e vlefshmërisë së licencës nr.064/TVL dhënë personit fizik z. Armand Baze për TV “abc”, për një periudhë prej një vit.
2. Afati i përfundimit të licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi është data 6.2.2008.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Halil Lalaj

KËRKESË

Shtetësja Tatjana Kacaj kërkon shpalljen të vdekur të bashkëshortit të saj, Ilirjan Kacaj, lindur dhe banues në Shkodër.

KËRKUESE
Tatjana Kacaj

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Hyri në shtyp më 6.7.2006
Doli nga shtypi më 8.7.2006

Tirazhi: 4000 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë